



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 997/3 Prot.

Tiranë, më 29/10/2015

VENDIM
“ Për rrëzimin e ankesës”

Nr 48, datë 29/10/2015

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

V Ë R E N:

Ankuesi ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit ankesën nr. 997 Prot., datë 08.10.2015, ndaj Autoritetit Publik/ Rektoratit të Universitetit Aleksandër Moisiu Durrës me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumentave zyrtare”.

Ankuesi, në cilësinë e kërkuesit, me shkresën e datës 14.09.2015 i ka kërkuar Rektoratit të Universitetit Aleksandër Moisiu Durrës një kopje të vendimit të Rektorit me emrat e fituesve dhe renditjen përfundimtare të kandidatëve të konkursit për personel akademik me kohë të plotë në Departamentin e Shkencave Politike, Fakultetit i Shkencave Politike-Juridike. Me shkresën nr.933/1 Prot., datë 22.09.2015 Rektorati i ka kthyer përgjigje duke e njoftuar se konkursi i zhvilluar në datën 9 shtator 2015 është anuluar dhe për pasojë nuk janë shpallur kandidatë fitues. duke mos qenë dakort me përgjigjen e autoritetit publik, në vijim ka bërë ankesë pranë zyrës së Komisionerit duke kërkuar që t’i vihet në dispozicion një kopje e vendimit të anulimit të këtij konkursi nga ana e Rektoratit të Universitetit Aleksandër Moisiu Durrës.

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, Komisioneri pas vlerësimit të ankesës, verifikimit të fakteve dhe bazës ligjore të saj, me Urdhri nr. 201 datë 09.10.2015, urdhëroi kryerjen e inspektimit administrativ pranë Autoritetit Publik/ Rektoratit të Universitetit Aleksandër Moisiu Durrës. Pranë këtij autoritetit u depozitua Urdhri i inspektimit administrativ dhe u protokollua me nr. 1033 Prot., datë 13.10.2015.

Gjatë inspektimit, nga ana e Rektorit dhe Shefes së Burimeve Njerëzore, u sqarua se konkursi i datës 9 shtator 2015 është anuluar për shkak se komisioni ad hoc i ngritur për këtë konkurs ka kaluar kompetencat e përcaktuara nga Këshilli i Fakultetit lidhur me kriteret e pranimit. Rektori me urdhrin nr.98/1., datë 15.09.2015, ka anuluar procesin e rekrutimit në Departamentin e Shkencave Politike dhe me anë të shkresës nr. 933/2 Prot., datë 12.10.2015 ka njoftuar

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se Autoriteti Publik/ Rektorati i Universitetit Aleksandër Moisiu Durrës ka përmbushur detyrimin në kuadër të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” duke i kthyer përgjigje kërkuetit brenda afateve ligjore.
Në përfundim, në lidhje me ankesën e _____ ndaj Rektoratit të Universitetit Aleksandër Moisiu Durrës, Komisioneri vlerëson se ajo rezulton e pa bazuar në ligj dhe si e tillë duhet rrëzuar.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjën c) të pikës 5 të nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

V E N D O S A:

1. Rrëzimin e ankesës nr. 997 Prot., datë 08.10.2015 të _____ kundër Autoritetit Publik/ Rektoratit të Universitetit Aleksandër Moisiu Durrës.
2. Kundër këtij vendimi ankuesi ka të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative kompetente, në përputhje me nenin 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
3. Ky vendim u dha sot në datë 29.10.2015.

